



Biografia

Ismail Kadare lindi më 28 janar 1936 në Gjirokastrë, ku përfundoi edhe arsimin e mesëm; më 1958 mbaroi degën e Gjuhës e të Letërsisë në Universitetin e Tiranës. Më pas shkoi në Moskë me studime për dy vjet në Institutin "Gorki". Ismail Kadare është shkrimtari më i madh i letërsisë shqipe dhe një nga shkrimtaret më të mëdhenj të letërsisë botërore bashkëkohore. Me veprën e tij, që ka shënuar një numër rekord të përkthimeve (në rreth 32 gjuhë të huaja) ai e ka bërë të njohur Shqipërinë në botë, me historinë dhe me kulturën e saj shekullore.

Rrugën e krijimtarisë letrare e nisi si poet që në vitet e gjimnazit, por u bë i njohur sidomos me vëllimin *Shekulli im* (1961), që u pasua nga vëllimet e tjera poetike, si: *Përse mendohen këto male* (1964), *Motive me diell* (1968) dhe *Koha* (1976). Vepra poetike e Ismail Kadaresë shquhet për idetë e thella dhe për figuracionin e pasur e origjinal; rol me rëndësi për pasurimin e poezisë shqiptare.

Në fushën e prozës, Ismail Kadare ka lëvruar tregimin, novelën dhe romanin. Prozën e tij e karakterizojnë përgjithësimet e gjëra historiko-filozofike, subjekti i ngjeshur dhe mendimi i thellë i shprehur shpesh me anë të parabolës, mbi bazën e asociacionit apo të analogjive historike. Ideja e romanit *Gjenerali i ushtrisë së vdekur* (1964) është shpirti liridashës i popullit shqiptar. Temën e shpirtit të pamposhtur të shqiptarëve nëpër shekuj autori e trajtoi edhe në romanin *Kështjella* (1975). Në romanin *Kronikë në gur* (1970) Kadare kritikoi psikologjinë provinciale dhe traditat prapanike. Probleme të rëndësishme të historisë janë trajtuar edhe në përmbledhjet me tregime e novela *Emblema e dikurshme* (1977), *Ura me tri harqe* (1978) dhe *Gjakftohtësia* (1980). E veçanta e talentit të Ismail Kadaresë shfaqet sidomos në trajtimin, nga një këndvështrim i ri, i temës historike dhe në tingëllimin e mprehtë aktual që është i aftë t'i japë asaj. Një nga krijimet më të shquara të Ismail Kadaresë dhe të të gjithë letërsisë së re shqiptare është romani *Pallati i ëndrrave* (1981). Shumica e veprave të Ismail Kadaresë janë përkthyer në shumë gjuhë të botës dhe janë pritur shumë mirë nga publiku lexues.



Libri që botoi Kadare në vitin 2006 "Identiteti evropian i shqiptarëve - sprovë"[1] pjesë e të cilit u botuan edhe nga gazeta Shekulli ka shkaktuar një polemikë në mes të tij dhe Rexhep Qosjes. Kështu përderisa Kadare e karakterizon identitetin shqiptarë si perëndimorë, Qosja në librin e tij të quajtur "Realiteti i shpërfillur"[2], thotë se identiteti shqiptar është një miks i atij perëndimor dhe lindor, krishterë dhe mysliman.

Tituj të veprave

- *Shih edhe Përkthimi i veprës së Ismail Kadaresë*
- *Frymëzime djaloshare - 1954*
- *Shekulli im - (1961)*
- *- roman- 1963*
- *Përse mendohen këto male - 1964*
- *Dasma - 1968*
- *Motive me diell - (1968)*
- *Kështjella - roman - 1970*
- *Kronikë në gur - roman - 1971*
- *Koha (1976)*
- *Dimri i madh - roman - 1977*
- *Ura me tri harqe - 1978*
- *Prilli i thyer - 1980*

- *Gjakftohtësia - përmbledhje novelash - 1980*
- Nata me hënë - 1985
- Koha e shkrimeve - 1986
- Koncert në fund të dimrit - 1988
- Vepra Letrare - 1981-1989
- Dosja H - 1990
- Piramida - 1992
- Shqipëri - 1995
- Pallati i ëndrrave - 1996
- Dialog me Alain Bosquet - 1996
- Spiritus - roman- 1996
- Kushëriri i engjëjve - ese- 1997
- Poezi - 1997
- Kombi shqiptar në prag të mijëvjeçarit të tretë. Tiranë: Onufri. ISBN 9992730161, ISBN 9789992730164. (scribd.com) - ese - 1998
- Tri këngë zie për Kosovën - triptik - 1998
- Ikja e shtërgut - tregim - 1999
- Qorrfermani - roman - 1999
- Vjedhja e gjumit mbretëror - tregime - 1999
- Ra ky mort e u pamë - ditare për Kosovën, artikuj, letra - 2000
- Kohë barbare (Nga Shqipëria në Kosovë) - biseda - 2000
- Brezitetë e Hankonatëve - 2000
- Vajza e Agamemnonit - 2000
- Bisedë përmes hekurash - 2000
- Elegji për Kosovën - 2000
- Lulet e ftohta të marsit - roman - 2000

- Unaza në kthetra - 2001
- Eskili, ky humbës i madh - 2001 (ribotim)
- Qyteti pa reklama - roman - 2001
- Jeta, loja dhe vdekja e Lul Mazrekut - roman - 2002
- Pasardhësi - roman - 2004
- Shkaba - 2004
- Dantja i pashmangshëm - 2005
- Identiteti evropian i shqiptarëve - 2006
- Hamleti, princi i vështirë - Sprovë - 2006
- Spiritus - 2007
- Çështje të marrëzisë -
- Poshtërimi në Ballkan -
- Muzgu i perëndive të stepës -
- Darka e gabuar - roman - 2008

Nderime

Ismail Kadare më 23.06.2009 u nderua me Çmimin e madh spanjoll, "Princi i Asturias per Letersi", nje nga çmimet me prestigjoze letrare në botë. Ai doli fitues mes 31 kandidateve nga 25 vende të ndryshme të botës ku dallohet emri i Milan Kunderas apo italiani Antonio Cabucchi.

Ky çmim u akordohet personave, institucioneve, puna krijuese ose kerkimore e te cileve perfaqeson nje kontribut te madh ne kulturen universale ne fushat e letërsise apo gjuhësisë.

Fituesja e cmimit "Princi i Asturias per Letersi" në vitin 2008 ishte kanadezja, Margaret Atwod, të cilën juria e nderoi per vepren e saj te shkëlqyer, në mbrojtjen e dinjitetit të grave.

Skenare filmash

* Cendres et sang (2009)

- * Abril Despedaçado (2001)
- * Avril brisé (1987)
- * Të paftuarit (1985)
- * Generale dell'armata morte, Il (1983)
- * Ballë për ballë (1979)
- * Radiostacioni (1979)

Mirënjohjet

- * Medalja e Artë e Lidhjes së Prizrenit, Kosovë
- * Man Booker International Prize, Britani, 2005
- * Premio Príncipe de Asturias de las Letras, Spanjë, 2009